



Republika e Kosovë  
Komuna e Drenasit  
Kuvendi i Komunës



Nr. 12-060101-5417 dt. 04/02/ 2021

### PROCESVERBALI

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më dt. 21.01.2021, ora 10:00.  
Mbledhjen e kryesoi Labinot Halilaj-Kryesues.

*Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për politikë dhe financa ku të pranishëm ishin anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj, Gani Podrimqaku, Florentina Elezi, Fitore Morina, Edolina Plakiqi, Burim Bujupi dhe Blerina Gashi. Prezent gjatë mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa ishin: Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, shefi i Kabinetit të Kryetarit Flamur Curri, Drejtori për Buxhet dhe financa Shyqyri Bublaku.*

Komiteti filloi punimet më këtë:

### Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 21.12.2020.
2. Raporti Financiar i zhvillimit të Buxhetit Janar – Dhjetor 2020.
3. Raporti vjetor i Komiteteve Konsultative për vitin 2020:
  - a. Komiteti për Persona me Aftësi të Kufizua.
  - b. Komiteti për Arsim Kulturë Rini dhe Sport.
  - c. Komiteti për Zhvillim Ekonomik Mbrojtje të Ambientit Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
  - d. Komiteti për Barazi Gjinore.
4. **Propozim** Vendim për caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së Heroit të Kombit Asllan Fazliu .
5. Të ndryshme.

**Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj:** hapi mbledhjen e KPF, pasi përshëndeti të pranishmit, prezantoi rendin e ditës ,fjalën ja dha Kryetarit të Komunës Ramiz Lladrovci i cili propozoi një pikë shtesë për rendin e ditës: 1. **Propozim** Vendim për caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së Heroit të Kombit Asllan Fazliu .

Kryesuesi fjalën e merr, **Burim Bujupi-** Faleminderit Kryesues unë kam një kërkesë për rendin e ditës për Shaip Heta me siguri ju ka ardhur edhe juve kërkesa për shërim jashtë vendi e ka gjendjen e rëndë shëndetësore nëse kemi mundësi me i ndihmuar diçka nga KPF.

**Kryetari Ramiz Lladrovci** përgjigjet: Burim unë e kam marrë kërkesën zyrtarisht sa po nënshkrova me provu me i aloku 2000€, por nuk kam vetëm 1500,se nuk kam të drejtë më shumë pa e dërguar në Kuvend ne nuk kemi tash jena në muajin Janar ku mjetet janë ende të pa alokuara dhe parashikimet për subvencione janë bërë për me vonë, sepse subvencionet i dhamë pasi ta bëjmë shpalljen publike për aplikime të ndryshme sport ,kulturë rini etj. Nuk kemi tash po ne po provojmë të bëjmë të mundshme pa e dërguar në Kuvend, që unë kam drejtë me rregullore 1500€. Bile kam pas thane as ato nuk po dua me i bërë se kanë 5000€, a diçka se kam dashtë me kalua gjithçka përmes Kuvendit po ministria ka tha duhet me pas një shumë të caktuar çdo Kryetar dhe na e kemi lanë qita. Jemi duke e bere për 1500€, ato sajnë pare po aj 50.000 ja ka miratua Ministria i duhen edhe nja 20.000,na këna mi ndihmua dhe qytetarët janë duke i ndihmuar me të madhe po si institucion në momentin e parë që me i lejon Ministria unë brenda njëzetekatër orëve mundem me ja derdhë në bankë, tjetër rrugë nuk kam. Sepse nuk është vetëm ai në Kosovë e këna pas qikën e vellaut të Bekim Dobrës 9-vjeqare prej një shumë të cilës varet jeta e saj për një shume për të cilën ne nuk kemi mundur qe ti ndihmojmë.

**Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj:** Pasi nuk pati diskutime hodhi në votim rendin e ditës , u votua ne mënyre unanime .

Hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: 1. **Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KPF-ca dt. 21 .12.2020.**

**Ka diskutime jo,** hodhi në votim pikën e parë të rendit e ditës , dhe kjo pike u votua ne mënyre unanime.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj-** hapi diskutimin për pikën e dytë: **2 Raporti Financiar i zhvillimit të Buxhetit Janar – Dhjetor 2020.**

**Fjalën e mori Drejtori i financave Shyqyri Bublaku-** Sa i përket buxhetit të vitit 2020,pas rishikimit te tij , buxheti i Komunës së Drenasit ka qenë me vlerë prej 16.530 459.€. Kjo shume është berë me rishikim te buxhetit ku kemi pasur një rezerve buxhetore prej 995 mije e cila është inkorporuar dhe është bartur ne investime kapitale. Sa i përket realizimit te të hyrave vetanake te Komunës se Drenasit apo si i quajmë ne të hyrat direkte te Komunës , kemi ngecje ne realizimin e te hyrave vetanake për vitin 2020. Duke e marre parasysh situatën e pandemisë e cila ka ndikuar në të gjitha poret e jetës por edhe në realizimin e të hyrave , ku realizimi i buxhetit prej të hyrave direkte është 884.984<sup>77</sup> cent apo 63.63% ,ndërsa shuma e realizuar nga te hyrat direkte , indirekte dhe grandet e donatorëve qe kemi përfituar si grandin e performances arrin shumën prej 1.480.372.40 , shume e cila nuk është e alokuar për vitin 2020 është alokuar. Është alokuar vetëm shuma prej 1 milionë e 13 mije euro mirëpo pritet te alokohet tash d.m.th. ketë vit. Sa i përket shpenzimit te buxhetit kisha me u ndal te tabela e fundit mos me ju marr edhe juve kohe edhe mos me ju mundu shume me shifra se raportin jau kam dorëzuar. Buxheti i ndare në sistemin e menaxhimit te financave publike për vitin 2020 për Kuvendin e Komunës se Drenasit është 17.775.422.<sup>37</sup> euro ndërsa shpenzimi për periudhën Janar – Dhjetor ka shkuar ne 15.586.255<sup>59</sup> euro apo 87.68% , një përqindje që për periudhën te cilën po raportojmë , duke e marre për baze situatën pandemisë mendoje qe është një përqindje e mire. Ku pagat kane shkuar

në shpenzimin qind për qind, mallrat-shërbimet 68.35% ,shpenzimet komunale 88.18% , subvencione dhe transfere 92.81% , ndërsa investimet kapitale 77.20% me buxhetin e alokuar e ndarë ne dispozicion te Komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj** :Nëse ka dikush diçka mundeni te diskutoni , nëse jo atëherë e rekomandojmë për kuvend.

Hapi diskutimin për pikën e tretë: 3. Raporti vjetor i Komiteteve Konsultative për vitin 2020:

- a. Komiteti për Persona me Aftësi të Kufizua.
- b. Komiteti për Arsim Kulturë Rini dhe Sport.
- c. Komiteti për Zhvillim Ekonomik Mbrojtje të Ambientit Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
- d. Komiteti për Barazi Gjinore.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj**- nëse nuk ka diskutime atëherë edhe kjo pike rekomandohet për kuvend ne mënyrë unanime.

**Kaloim te pika e katërt 4. Propozim Vendim për caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së Heroit të Kombit Asllan Fazliu .**

Fjalën e merr **Kryetari Ramiz Lladrovci** – E thamë edhe me herët e kemi shqyrtuar tre propozime ose 4 propozime për te cilat kemi ardhur në përfundim së shtatorja duhet të vendoset në rrugën ku e mban edhe emrin e tij. Një shesh i vogël qe mund te përgatitet dhe qe është vend shumë i përshtatshëm edhe është i mire dhe ajo rruge ka me qenë , jo rruga Asllan Fazliu po rruga tjetër Fehmi dhe Xheve Lladrovci, shumë shpejt ka me hyrë në sistem 4 korsi dhe ka me qenë një rruge e frekuentuar mjaftueshëm nga njerëzit. Ka me qenë një zonë ku i bënë nderë edhe rrugës edhe emrit apo kujt do qofte tjetër kështu qe ju kur te merrni vendimin qe do ta bëjmë edhe ajo fleta poseduese duhen gjera të tjera dhe ju kisha kërkuar qe me e rekomanduar për mbledhje të Kuvendit për arsye se dita e vrasjes se dëshmorit Asllan Fazliu është në Mars edhe ne mars pritet me e vendosë edhe shtatoren e ndërtuar me iniciative të familjes dhe bashkëluftëtareve të tij kështu qe unë i përgëzoje për punën qe e kane bërë dhe ne do te i ja krijojmë mundësitë qe ajo ne mënyre ligjore, në rrugë zyrtare te vendoset aty ku e ka edhe vendin.

**Arsyetim** : Duke pasur parasysh kontributin e dhënë të Dëshmorit të Kombit për çlirimin e vendit, Komuna e Drenasit cakton lokacionin për vendosjen e shtatores së heroit “Asllan Fazliu. Familja Fazliu, ka ndërtuar shtatoren e heroit ”Asllan Fazliu” me kontributin e familjes dhe bashkëluftëtareve të heroit, ndërsa Komuna e Drenasit merr për obligim caktimin e lokacionit për vendosje të shtatores.

Andaj, vendosja e shtatores ne parcelën nr. P-949-0, në zonën kadastrale në Drenas, vjen pasi që rruga në atë pjesë mban emrin e heroit, po ashtu ekziston hapësira e nevojshëm për ndërtim të sheshit dhe vendosje të shtatores.

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë ka kryer të gjitha matjet e nevojshme gjeodezike dhe ka përgatitur të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për definimin dhe caktimin e lokacionit të shënuar më lartë.

Të bashkangjitur keni kopjen e planit, certifikatën e pronësisë si dhe skica e lokacionit.


**Fjalën e merr Burim Bujupi**- Faleminderit Kryesues. Unë personalisht e përkrahe mendimin Kryetarit , mendoje qe është vendim i qëlluar meqenëse aty është emri i rrugës, ka hapësire mundet me u vendose aty, kisha pas dëshire qe ne rekomandim të shkruhet lokacioni, nga këtu nuk dëgjohet zëri .


**Kaloim te pika e pestë 5. Të ndryshme.**

Pasi nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime, kryesuesi i Kuvendit Komunal konsideroi si të mbyllur seancën.

***Mbledhja përfundoj rreth orës: 10: 50min.***

**Procesmbajtëse:**

  
**Zahrie Podrimqaku Subashi**

  
**Kryesuesi i Kuvendit**

**Labinot Halilaj**

